



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.104/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ndërmarrja Tregtare për Transport dhe Shërbime ["B..."] me seli në Shkup-Republika e Maqedonisë, të cilën e përfaqësonme autorizim avokati [A.I] nga Prishtina, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave-Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Nexhmije Karaçi, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.130/17 i datës 19/02/2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **03/11/2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave-Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë dhe **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.130/17 i datës 19/02/2019 dhe lënda kthehet në Gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor V.EK.nr.130/17 i datës 19/02/2019, ka vendosur si vijon: I.Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Ndërmarrja Tregtare për Transport dhe Shërbime ["B..."] me seli në Shkup, R. Maqedonisë dhe detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave-Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditëses për dëmin e shkaktuar si pasoje e konfiskimit të paligjshëm të autobusit për transport të udhëtareve me [targa ...], prej datës 22.01.2015 e deri me datë 04.05.2015, të kompensoj demin material në formë të fitimit të humbur në lartësi prej 19,397.67 euro, me kamat vjetore prej 8 % duke filluar nga data 12.11.2018 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

II. Detyrohet e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 1,797.60€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesën ta aprovon në tërësi si të bazuar, ta prish apo të ndryshon aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja ka dhënë përgjigje në ankesë, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e të paditurës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Ndërmarrja Tregtare për Transport dhe Shërbime ["B..."] me seli në Shkup-Republika e Maqedonisë, me datën 13/03/2017, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave-Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, me kërkesë të precizuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se e paditura Dogana e Kosovës në cilësinë e organit administrativ ka ndaluar për kontroll autobusin pronë e paditëses e të cilën e vozitëse [E.Z] dhe me rastin e ndaljes nën dyshimin për kontrabandë të mallrave dhe krijim të hapësirave të improvizuar post fabrikantë, me aktvendimin e datës 05.02.2015, nr, 92/2015, ka shqiptuar kundërvajtje për vozitësin [E.Z] dhe ka konfiskuar autobusin pronë e paditëses, ku ndaj këtij vendimi paditësja në cilësinë e ankuesit ka ushtruar ankese-kërkesë për rishqyrtim, e ku duke vendosur sipas ankesës organi i shkallës së dytë në cilësinë e të paditurës ka marr aktvendim nr.07.03/112 me të cilën pjesërisht ka anuluar aktvendimin e shkallës së parë duke e hequr masën e konfiskimit me arsyetim se nuk është vepruar drejte kur është konfiskuar autobusi pronë

e paditëses, pasi që i njëjti nuk ka pasur hapësira post fabrikantë dhe nuk është vërtetuar se mallrat e gjetura a janë të kontrabanduara apo jo, e po ashtu nga provat e administruara, gjykata vërtetoi faktin se si pasojë e veprimet të paditurës dhe konfiskimit të autobusit për 101 ditë gjegjësisht nga data 22/01/2015 e deri me datën 04/05/2015, këtu pala paditëse ka pësuar dëm material në formë të fitimit të humbur në lartësi prej 19,397.67 euro dhe mbi bazën e kësaj gjendje faktike ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 136 par.1 dhe 2, nenin 169.par.4, nenin 173 dhe nenin 174 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 183 dhe nenin 184 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e Kosovës, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa e të paditurës është e bazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, për shkak se nuk e ka vlerësuar me kujdes të shtuar ekspertizën financiare konform nenit 8 të LPK-së sepse e njëjta nuk bazohet në prova materiale bindëse respektivisht paditësja pretendon se ka paguar qiranë për autobusin e marr në shfrytëzim, por gjatë seancave gjyqësore paditësja nuk ka arritur të argumenton me asnjë provë se ka paguar qiranë e pretenduar ndërsa eksperti financiar nuk ka arritur të vërteton se shpenzimet e qirasë a janë të evidentuara në librat kontabël të paditëses apo jo, por eksperti bazohet kryesisht në oferta të cilat nuk janë parametër i mjaftueshëm për të ardhur deri në një përfundim të tillë, mandej kontrata e qirasë e cila gjendet në shkresat e lëndës e datës 24/01/2015 nuk është e protokolluar nga asnjëra palë kontraktuese dhe gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar as faktin relevant se gjatë periudhës kontestuese paditësja cilët autobusë i ka shfrytëzuar në këtë linje transporti dhe si rezultat i këtyre lëshimeve procedurale gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar gabimisht edhe të drejtën materiale. Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të prishet.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që të eviton shkeljet e theksuara si më lartë duke ftuar ekspertin financiar [R.B] që të plotëson mendimin dhe konstatimin e tij, në atë mënyrë që të siguron nga Policia Kufitare apo e paditura listën e

udhëtarëve të paditëses për periudhën kontestuese (hyrje-daljet e autobusit), me qëllim që të konstaton se me cilët autobus paditësja e ka mbajtur linjën përkatëse, nëse vërtetohet se linjat janë mbajtur me autobusë të marr me qira, atëherë të vërteton se këto shpenzime të qirasë a janë të evidentuara në librat kontabël të paditëses si dhe gjatë kësaj periudhe a ka pasur zvogëlim të të hyrave financiare të paditëses si dhe të vlerëson të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qëllim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.104/19, me datën 03/11/2020

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v